




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE



V E N D I M

Nr. 406, datë 19.6.2019

P Ë R

STRUKTURAT E KOMITETIT KOMBËTAR TË DIGAVE TË MËDHA
(KKDM)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 13, të ligjit nr.8681, datë 2.11.2000, "Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) përbëhet nga 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë, të cilët emërohen, si më poshtë vijon:
 - 1.1. Kryetari dhe nënkryetari emërohen për një mandat 5-vjeçar (pesëvjeçar) nga Kryeministri, me propozimin e ministrit përgjegjës për infrastrukturën.
 - 1.2. Sekretar i KKDM-së është sekretari i Sekretariatit Kombëtar të Digave të Mëdha (SKDM), pranë ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën.
 - 1.3. Anëtarët emërohen për një mandat 4-vjeçar (katërvjeçar) nga ministri përgjegjës për infrastrukturën, sipas propozimeve të mëposhtme:
 - a) 2 (dy) anëtarë nga ministria përgjegjëse për infrastrukturën (përfaqësues në fushën e energjisë dhe përfaqësues nga KESH-i);
 - b) 2 (dy) anëtarë nga ministria përgjegjëse për bujqësinë;
 - c) 1 (një) anëtar nga ministria përgjegjëse për emergjencat civile (që mbulon emergjencat civile);
 - ç) 1 (një) anëtar nga Universiteti Politeknik;
 - d) 1 (një) anëtar nga Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (specialist hidrolog);
 - dh) 1 (një) anëtar nga kryetari i Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha.

2. Këshilli Teknik i Përhershëm i Digave (KTPD) përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, që emërohen, për një mandat 5-vjeçar, nga ministri përgjegjës për infrastrukturën, me propozim të kryetarit të Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha (KKDM). Një prej anëtarëve do të jetë sekretar (specialist në SKDM) dhe një anëtar tjetër do të jetë përfaqësues i Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore.
3. Shpërblimi për pjesëmarrje në mbledhje, për çdo anëtar, bëhet sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njësive të qeverisjes qendrore.
4. Mjediset e punës për KKDM-në, SKDM-ITD-në dhe KTPD-në sigurohen nga ministria përgjegjëse për infrastrukturën.
5. Vendimi nr.745, datë 20.10.2011, i Këshillit të Ministrave, “Për strukturat e Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha (KKDM)”, të ndryshuar, shfuqizohet.
6. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRAÇE

MINISTRI I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSMINISTRI

HANTIN BONATI

NR.PROT. 3041/1
DATE 20.6. 2019

MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE
ENERGJISË
MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT
RURAL
MINISTRISË SË MBROJTJES
UNIVERSITETIT POLITEKNIK
KOMITETIT KOMBËTAR TË DIGAVE TË MËDHA
INSTITUTIT TË GJEOSHKENCAVE, ENERGJISË,
UJIT DHE MJEDISIT
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGAÇI

